



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 124

29 korrik

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 33, datë 12.7.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 39, datë 23.1.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 00-2010-644(499), datë 14.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).....	5285
Vendim i GJK nr. 34, datë 12.7.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 2133, datë 24.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr. 1537, datë 28.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 7188, datë 4.10.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1537, datë 28.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.....	5289
Vendim i BSH nr. 41, datë 26.6.2013	Për miratimin e rregullores “Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dyshuara si të falsifikuara”.....	5289
Vendim i BSH nr. 42, datë 26.6.2013	Për miratimin e rregullores “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqytjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë”.....	5303

VENDIM
Nr. 33, datë 12.7.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Admir Thanza	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Basha e Brunilda Bara, mori në shqyrtim në seancat plenare, me dyer të hapura më datë 11.10.2012 dhe mbi bazë dokumentesh më datë 18.12.2012, çështjen me nr. 30/8 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shefqet Merra

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 39, datë 23.1.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 00-2010-644(499), datë 14.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 27, pika 3, 32, pika 1, 33, 42, 58, 131, shkronja “f”, dhe neni 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 16, 152, 158, 415, 432 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, përfaqësuesin e kërkuetit, që kërkoi pranimin e kërkesës, subjektin e interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 431, datë 31.3.2008, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuetit Shefqet Merra për kryerjen e veprës penale “Mashttrim në dëm të disa personave”, parashikuar nga neni 143, pika 2 i Kodit Penal.

2. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkueti nëpërmjet përfaqësuesit, duke parashtruar shkaqet me shkrim brenda afatit ligjor. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 12.12.2008, ka njoftuar përfaqësuesin e kërkuetit për plotësimin e shkaqeve të ankimit sipas neni 415, pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale¹.

3. Megjithëse përfaqësuesi i kërkuetit ka marrë dijeni për plotësimin e të metave të ankimit, nuk i ka paraqitur ato. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 39, datë

¹ Neni 415 - Afatet e ankimit

1. Afati për të bërë ankim është dhjetë ditë. Ky afat fillon nga dita e nesërme e shpalljes ose njoftimit të vendimit.

2. Ai që ka bërë ankim ka të drejtë që deri pesë ditë para seancës të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, arsye të tjera që lidhen me ankimin.

3. Afatet e parashikuara nga ky nen mund të zgjaten për asnjë shkak, përveç rasteve të parashikuara me ligj.



23.1.2009, ka vendosur mospranimin e ankimit, në bazë të nenit 420, pika “c” të Kodit të Procedurës Penale².

4. Mbi rekursin e paraqitur nga kërkuesi nëpërmjet përfaqësuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2010-644(499), datë 14.5.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit.

5. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 39, datë 23.1.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 00-2010-644(499), datë 14.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pretendimet, në mënyrë të përmbledhur, paraqiten si më poshtë:

5.1. Vendimi nr. 39, datë 23.1.2009 i Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë në kundërshtim me nenin 33, pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, duke cenuar të drejtën për t’u dëgjuar nga gjykata.

5.2. Gjatë gjykimit, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë marrë prova e dëshmi në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin.

6. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, paraqiti prapësime me shkrim për çështjen objekt gjykimi si më poshtë:

6.1 Pretendimi për cenimin e të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur gjatë gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, është i pabazuar. Në këtë gjykim, megjithëse përfaqësuesi i kërkuesit ka marrë dëgjimin, nuk është paraqitur në seancë.

6.2 Lidhur me pretendimin për vlerësimin e provave dhe interpretimin e zbatimit të ligjit material penal nga gjykatat e zakonshme, kërkuesi nuk legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi këto pretendime nuk lidhen me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

6.3 Lidhur me pretendimin se gjykatat kanë marrë dëshmi në shkelje të nenit 32/1 të Kushtetutës dhe neneve 16 e 158 të Kodit të Procedurës Penale, kërkuesi nuk legjitimohet pasi nuk ka shteruar mjetet juridike.

II

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

7. Gjykata, lidhur me zhvillimin e seancës plenare mbi bazë dokumentesh, në datën 18.12.2012 vlerësoi riçeljen e saj, bazuar në kriteret e neneve 23 dhe 73, pika 3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

8. Në analizën e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata, paraprakisht, konstaton se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që i ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u dëgjuar nga gjykata

9. Kërkuesi pretendon se gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë është zhvilluar në mungesë të tij dhe të mbrojtësit të zgjedhur, pa u njoftuar për ditën e orën e zhvillimit të gjykimit. Atij nuk i

² Neni 420 - Mospranimi i ankimit

1. Ankimi nuk pranohet: a) kur është bërë nga ai që nuk është i legjitimuar; b) kur vendimi është i paankimueshëm; c) kur nuk janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit; ç) kur është hequr dorë nga ankimi.

2. Mospranimi mund të deklarohet, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

3. Vendimi i mospranimi i njoftohet atij që ka bërë ankimin dhe kundër tij mund të bëhet rekurs në Gjykatën së Lartë.

është dhënë mundësia për të marrë pjesë në gjykim, duke cenuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. Në mënyrë konstante, në një sërë vendimesh të saj, Gjykata e ka pranuar ekzistencën e mbrojtjes si tregues thelbësor të një procesi të rregullt penal. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 18, datë 2.4.2012; nr. 57, datë 21.12.2012*).

11. Gjykata rithekson se parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëjloj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*shih vendimet nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 5, datë 17.2.2003 dhe nr. 33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas praktikës së kësaj Gjykate, si dhe të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigorozë, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rreptësi një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit ose i mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj. (*shih vendimet: nr. 19, datë 18.9.2008; nr. 13, datë 21.7.2008; nr. 16, datë 8.6.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në çështjen në shqyrtim rezulton se kërkuesi, në bazë të prokurës së posaçme nr. 1434 Rep. dhe nr. 129 Kol., datë 2.3.2006, ka caktuar avokat A.B. si përfaqësues të tij në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në mungesë të tij. Pas vendimit nr. 431, datë 31.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuesi i kërkuesit ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata, në bazë të nenit 415, pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e ndërmjetëm të datës 12.12.2008, ka vendosur t'i japë kohë përfaqësuesit të kërkuesit të plotësojë shkaqet e ankimit. Ankimi nuk është plotësuar dhe, në këto kushte, gjykata ka vendosur mospranimin e ankimit, bazuar në nenin 420, pika "c" të Kodit të Procedurës Penale.

13. Nga materialet e ndodhura në dosje rezulton se, në bazë të prokurës së posaçme, avokati A.B. ka pasur tagër përfaqësimi edhe në mungesë të kërkuesit. Ankimi i paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë i firmosur nga vetë përfaqësuesi i kërkuesit. Gjatë gjykimit të zhvilluar në këtë gjykatë, rezulton se përfaqësuesi ka pasur dijeni për procesin e zhvilluar, sipas fletëhirrjeve të seancave të datave 21.11.2008, 12.12.2008 dhe 23.1.2009, por nuk ka qenë i pranishëm dhe nuk ka paraqitur shkaqe për mungesën. Gjykimi është shtyrë për t'i dhënë kohën e mjaftueshme për të plotësuar ankimin e paraqitur. Në seancën e datës 23.1.2009 Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në nenin 412, 415, pika 2 e 3, dhe 420, pika 1, shkronja "c" të Kodit të Procedurës Penale, në kushtet kur shkaqet e ankimit nuk janë plotësuar, ka vendosur mospranimin e tij. Gjykata në rastin e vendimit për mospranimin e ankimit kufizohet në vlerësimin nga ana formale të ankimit dhe nuk shqyrton çështjen në themel, për t'i dhënë mundësi palëve të dëgjohen dhe të mbrohen duke paraqitur argumentet e tyre. Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka shqyrtuar çështjen në themel ndërsa, lidhur me njoftimin e kërkuesit dhe përfaqësuesit të tij, ka zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

14. Sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, është i pabazuar.



B. Për pretendimin se gjykatat kanë pranuar e vlerësuar prova në kundërshtim me ligjin

15. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pranuar dhe vlerësuar prova në kundërshtim me ligjin. Konkretisht, ai parashtrohet se gjykata nuk ka vlerësuar drejt dëshminë e shtetasve A.Q., e dëmtuar nga vepra penale. Dëshmia e të dy shtetasve të tjerë, M.LL. dhe kunatit të tij, janë të pabazuara. Gjykata ka marrë si provë dëshminë e shtetasit B.K., pa e thirrur të dëshmojë, por duke lexuar thëniet e tij. Gjithashtu, ka marrë dëshminë e vëllait dhe të motrës së kërkuesit, në kundërshtim me nenin 32, pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

16. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit, si rregull, interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve, rrethanave dhe provave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Lidhur me pretendimin se gjykata e zakonshme ka marrë si provë dëshminë e shtetasit B.K. duke lexuar thëniet e tij e duke mos e thirrur të dëshmojë, Gjykata arrin në përfundimin se ky pretendim është i pabazuar. Rezulton se pas njoftimit nga gjykata e zakonshme dëshmitari nuk është gjendur në adresën e kërkuar. pasi ishte larguar. Në këto kushte gjykata ka zbatuar nenin 369, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale³, duke proceduar me leximin e deklarimeve të tij para organit të akuzës, të cilat janë vlerësuar me tërësinë e provave. Në lidhje me pretendimin për marrjen e dëshmisë së vëllait dhe motrës së kërkuesit në kundërshtim me nenin 32, pika 1 të Kushtetutës, rezulton se kërkuesi këtë pretendim nuk e ka parashtuar në rekursin në Gjykatën e Lartë, si rrjedhim nuk ka shteruar mjetet juridike.

18. Në vështrim të standardeve të mësipërme, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuesit mbi procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit.

19. Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit Shefqet Merra nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

³Neni 369, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale.

Leximi i deklarimeve të bëra nga shtetasi shqiptar ose i huaj, banues jashtë shtetit, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur ose kur nuk gjendet, me gjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore, si dhe kur refuzon të dëshmojë. Në këtë rast akti vlerësohet duke u lidhur me provat e tjera.

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha.

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Admir Thanza.

VENDIM

Nr. 34, datë 12.7.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“	
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	
Gani Dizdari	anëtar i	“	“	
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“	
Fatos Lulo	anëtar i	“	“	
Sokol Berberi	anëtar i	“	“	

me sekretare Blerina Basha, në datën 28.5.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 13 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shpresa Lakuriqi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Parashqevi Themeli, Elisabeta Lakuriqi, Marjeta Zografi.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve nr. 2133, datë 24.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dhe nr. 1537, datë 28.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 7188, datë 4.10.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1537, datë 28.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja është bashkëpronare, me 1/4 pjesë, e një ndërtese dhe trualli prej 133.5 m², të ndodhur në Tiranë. Subjektet e interesuara janë bashkëpronarë, me 3/4 pjesë, mbi të njëjtin truall dhe ndërtesë.



2. Pas përfundimit të gjykimit të fazës së parë të pjesëtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lejimin e pjesëtimit dhe ka përcaktuar pjesët ideale që u takojnë kërkueses dhe subjekteve të interesuara. Gjykata caktoi një eksperte për vlerësimin e sendeve që do t'i nënshtroheshin pjesëtimit dhe përcaktimin e mundësisë së ndarjes në natyrë të tyre.

3. Me vendimin nr. 7188, datë 4.10.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar padinë për fazën e dytë të pjesëtimit dhe ka vendosur pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, truall me sipërfaqe 133.5 m² dhe shtëpi e ndërtuar mbi truall me sipërfaqe 66.25 m², duke e lënë në pronësi të kërkueses dhe duke përcaktuar detyrimin e kësaj të fundit t'u paguajë subjekteve të interesuara kundërvlerën e pjesëve takuese të tyre.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1537, datë 28.6.2011, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka vendosur ndarjen në natyrë të truallit dhe shtëpisë ndërmjet kërkueses dhe subjekteve të interesuara.

5. Kërkuësja ka bërë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1537, datë 28.6.2011, në Gjykatën e Lartë, e cila është pranuar.

6. Në vijim, kërkuësja ka ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. 1537, datë 28.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit.

7. **Kërkuësja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, për shkak se:

7.1 Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është rezultat i një gjykimi jo të drejtë, pasi ndarja në natyrë nuk plotëson standardet më minimale të banimit dhe nuk është funksionale. Sipas kësaj ndarjeje kërkueses dhe 2 fëmijëve të saj të rritur u takon vetëm një dhomë, e cila nuk është funksionale pasi duhet hapur derë dhe duhen bërë punime të tjera (elektrike, hidraulike etj);

7.2 Në kushtet kur nuk ka një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë për pjesëtimin e pasurisë, zgjidhja që ka dhënë gjykata e apelit është e ndryshme nga zgjidhja e dhënë nga gjykatat e tjera të shkallës së parë në situata identike;

7.3 Gjykata e Apelit Tiranë ka interpretuar gabim ligjin material sipas të cilit shtëpia e banimit i jepet bashkëpronarit që ka nevojë ose banon në atë shtëpi (neni 207 i Kodit Civil). Kërkuësja dhe fëmijët e saj banojnë në shtëpinë në fjalë, ndërsa subjektet e interesuara banojnë në shtëpi të tjera;

7.4 Gjykata e Apelit Tiranë ka cenuar barazinë e armëve, pasi nuk ka pranuar kërkesën për të thirrur një ekspert të paanshëm për të dhënë mendim për sipërfaqen dhe mundësinë e ndarjes apo jo në natyrë;

7.5 Megjithëse në rekurs ishin paraqitur shkaqe ligjore dhe kushtetuese, Gjykata e Lartë nuk e kaloi çështjen për shqyrtim dhe nuk i dha përgjigje problemeve të ngritura në rekurs, megjithëse vetë kjo gjykatë e kishte pezulluar më parë ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas kërkueses, vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, është i paarsyetuar.

8. **Subjektet e interesuara** kanë paraqitur me shkrim prapësimet si vijon:

8.1 Pretendimi i kërkueses, se nuk ka vendim unifikues të Gjykatës së Lartë për pjesëtim pasuror, nuk përbën shkak për gjykimin kushtetues dhe nuk rezulton në mungesën e një procesi të rregullt ligjor;

8.2 Eksperti i kërkuar nga kërkuësja nuk ka qenë i caktuar nga gjykata dhe mendimi i tij nuk ka cilësinë e provës;

8.3 Gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe ai në Gjykatën e Lartë janë zhvilluar në respektim të nenit 42 të Kushtetutës, të së drejtës së bashkëpronësisë dhe normave procedurale civile.

II Vlerësimi i Gjykatës

A) Për pezullimin e zbatimit të vendimit gjyqësor

9. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 7188, datë 4.10.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1537, datë 28.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata i vlerësoi të pabazuara argumentet e parashtruara nga kërkuuesja për cenimin e interesave të saj nga zbatimi i menjëhershëm i vendimit të mësipërm gjyqësor dhe, për rrjedhojë, vendosi rrëzimin e kërkesës.

B) Për pretendimin e cenimit të barazisë së armëve

10. Pretendimin për cenimin e barazisë së armëve kërkuuesja e ka mbështetur në mospranimin nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë të kërkesës së saj për të thirrur një ekspert të paanshëm, i cili do të jepte mendim për sipërfaqen dhe mundësinë e ndarjes apo jo në natyrë të saj.

11. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se barazia e armëve është një aspekt i rëndësishëm i konceptit të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ky parim nënkupton që secilës palë në proces t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet (ku përfshihet edhe paraqitja e provave nga ana e saj), në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të dukshëm në raport me palën tjetër. Parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin civil, u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre (*shih vendimet nr. 34, datë 25.7.2011 dhe nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Ajo ka theksuar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e këtyre gjykatave (*shih vendimet nr. 47, datë 7.11.2011 dhe nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata konstaton se akti i ekspertimit i datës 7.4.2010 është kryer nga ekspertja e caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit i ka dhënë ekspertës si detyrë, ndërmjet të tjerash, të përcaktojë nëse është e mundur ndarja në natyrë e pasurisë dhe ekspertja ka paraqitur në akt-ekspertim dy variante të ndarjes në natyrë, sipas kushteve të përcaktuara në pyetjet e gjykatës (f. 13-19 të akt-ekspertimit). Në referim të parashikimeve të Kodit Civil (KC), Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, ekspertja ka dhënë mendim se prona mund të ndahet në natyrë, duke pasur parasysh respektimin e disa kritereve, që janë: a) moscenimi i qëllimit përkatës të pronës; b) moscenimi i konstruksionit dhe qëndrueshmërisë së godinës; si dhe c) moscenimi i pronave kufitare apo krijimi i servituteve të reja. Në vijim, ajo ka paraqitur dy variante të mundshme të ndarjes në natyrë, pasi ka vlerësuar se të dyja këto variante përmbushin kriteret e përcaktuara më sipër dhe respektojnë funksionalitetin e pronës. Pjesa e kërkueses dhe e secilës nga subjektet e interesuara është vlerësuar nga ekspertja në shumën 2 428 000 lekë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në projektin e pjesëtimit, në nenin 207 të KC-së, si dhe në vlerësimet e ekspertës të pasqyruara në aktin e ekspertimit, ka vendosur pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, duke e lënë në pronësi të kërkueses dhe duke detyruar këtë të fundit t’u paguajë subjekteve të interesuara kundërvlerën e pjesëve takuese të tyre.

13. Për të bindur Gjykatën e Apelit Tiranë për nevojën e thirrjes së një eksperti tjetër, kërkuuesja ka paraqitur mendimin teknik të një eksperti tjetër, i cili kishte konkluduar se “ndarja teknike funksionale në dy pjesë...nuk mund të realizohet”. Gjykata e Apelit Tiranë nuk e ka quajtur të domosdoshme marrjen e një eksperti tjetër të kërkuar nga kërkuuesja, dhe ka çmuar të zgjidhë mosmarrëveshjen duke zbatuar variantin e dytë të ndarjes në natyrë, të paraqitur nga ekspertja e



caktuar nga gjykata, pasi kështu, sipas saj, secila palë përmbush interesat e veta ekonomike dhe realizohet drejtësia sociale.

14. Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së saj të cituar më sipër, thekson se barazia e armëve nuk nënkupton që gjykata duhet të pranojë çdo kërkesë apo provë të paraqitur nga pala. Në rastin konkret Gjykata vlerëson se mospranimi, nga ana e Gjykatës së Apelit, i kërkesës për kryerjen e një akt-ekspertimi tjetër, nga një ekspert i caktuar nga kërkuësja, nuk ka cenuar parimin e barazisë së armëve gjatë procesit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës në këtë drejtim është i pabazuar.

C) Për pretendimet e tjera

15. Kërkuësja ka pretenduar, ndër të tjera, se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është rezultat i një gjykimi jo të drejtë, pasi ndarja në natyrë nuk plotëson standardet më minimale të banimit dhe zgjidhja që ka dhënë kjo gjykatë është e ndryshme nga zgjidhja e dhënë nga gjykatat e tjera në situata identike. Sipas kërkuësës, Gjykata e Apelit Tiranë ka interpretuar gabim ligjin material sipas të cilit shtëpia e banimit duhet t'i jepej kërkuësës, e cila banon në atë shtëpi.

16. Në vlerësimin e Gjykatës, këto pretendime të kërkuësës kanë të bëjnë në thelb me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe zbatimin e ligjit nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, pra bëhet nga gjykatat e zakonshme, kurse detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material, apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme, pasi një gjë e tillë do ta kthente atë në një instancë të katërt (*shih vendimet nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 23, datë 17.5.2011 dhe nr. 106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011 dhe nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këto arsye, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësës, të parashtruara në pikën 15 më sipër, janë haptazi të pabazuara.

17. Kërkuësja ka pretenduar, gjithashtu, se megjithëse në rekurs ishin paraqitur shkaqe ligjore dhe kushtetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e kaloi çështjen për shqyrtim dhe nuk i dha përgjigje problemeve të ngritura në rekurs. Sipas saj, për këto shkaqe, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për mospranimin e rekursit, është i paarsyetuar.

18. Gjykata është shprehur dhe herë të tjera për rolin që ka dhoma e këshillimit, duke vlerësuar se sikundër për pranimin ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimin nr. 4, datë 25.2.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata.

19. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka nënvizuar se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk përbën proces të parregullt ligjor dhe nuk paraqet ndonjë mangësi në këtë drejtim. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 108, datë 3.10.2012 dhe nr. 17, datë 17.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nisur nga sa më sipër, në rastin konkret, forma e kufizuar e arsyetimit, e vendimit të mospranimit të rekursit, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit, në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, ndaj edhe pretendimi i kërkueses, në këtë aspekt, është haptazi i pambështetur.

21. Si përfundim, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se pretendimet e ngritura nga kërkuësja në drejtim të cenimit të së drejtës për një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari.

MENDIM PAKICE

Jemi kundër vendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

1. Kërkuësja, Shpresa Lakuriqi, ka kërkuar nga kjo Gjykatë shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 1537, datë 28.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe të vendimit nr. 2133, datë 24.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

2. Në thelb kërkuësja ka pretenduar se vendimi i sipërpërmendur i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke ndryshuar një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të dhënë në favor të saj, me objekt pjesëtim i pasurisë së paluajtshme, dhe duke bërë ndarjen në natyrë të truallit dhe shtëpisë, ndonëse ka zgjedhur një nga dy variantet e mundshme ligjore të përcaktuara dhe në mendimin e ekspertit, ka marrë një vendim të padrejtë për shkak të pamundësisë së ndarjes në natyrë të pasurisë objekt konflikti. Sipas kërkueses, ndarja në natyrë e pasurisë, e konsideruar, sipas saj, me të drejtë, si e papranueshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, jo vetëm nuk është funksionale, por nuk plotëson as standardet më minimale të banimit.

3. Kërkuësja ka pretenduar, gjithashtu, se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), duke mos vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, i ka mohuar të drejtën e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për më tepër, sipas kërkueses, vendimi i Kolegjit në fjalë nuk plotëson as standardet minimale të arsyetimit të vendimit, përderisa nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë ligjore dhe kushtetuese.



4. Mendojmë se pretendimi i fundit i kërkueses është i drejtë dhe i bazuar dhe, si i tillë, duhej pranuar, duke u vendosur shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 2133, datë 24.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

5. Sipas këndvështrimit tonë, në një shtet të së drejtës, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të jenë aktive për t'i zgjidhur drejt konfliktet, sepse jo gjithmonë zgjidhjet ligjore janë detyrimisht edhe të drejta. Në këtë drejtim, mendojmë se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i pazëvendësueshëm. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Kemi parasysh këtu, veç të tjerave, edhe të drejtën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të marrë vendime për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

6. Çështja, objekt shqyrtimi, paraqet veçori të kësaj natyre pikërisht për faktin se në dy mundësitë e ofruara nga ligjvënësi për zgjidhjen e konflikteve që lidhen me pjesëtimin e pasurive të paluajtshme, që janë ndarja e saj me "ligj" dhe ndarja në natyrë, gjykatës i duhet të zgjedhë atë që paraqitet më e drejtë dhe që përmbush në mënyrë të kënaqshme interesat e palëve.

7. Në këtë çështje, dy gjykata të niveleve të ndryshme, ajo e shkallës së parë dhe ajo e apelit, i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta zgjidhjes së këtij konflikti. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë duke pranuar padinë, ka vendosur t'ia lerë pasurinë (truall plus shtëpi banimi) në pronësi kërkueses, dhe detyrimin e saj që t'u paguajë subjekteve të interesuara, bashkëpronarë, kundërvlerën në lekë të pjesëve takuese. Ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar këtë vendim duke gjykuar si më të përshtatshme ndarjen në natyrë të pasurisë. Ndonëse të dy vendimet nga pikëpamja formale juridike janë të ligjshme, vetëm një prej tyre është dhe duhet të jetë i drejtë. Për zgjidhjen e këtij problemi kërkuessa i është drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar prej saj, si gjykatë më e lartë, të bëjë rolin e "arbitrit" për një gjykim të padrejtë që ka bërë Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, sipas saj, ndër të tjera, jo vetëm ka interpretuar gabim ligjin material por ka cenuar dhe standardin kushtetues të barazisë së armëve. Këtyre pretendimeve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ndonëse më parë kishte vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, i përgjigjet me një vendim standard formal mospranimi të rekursit, i cili nuk përmban asnjë arsytim jo vetëm për të kuptuar shkaqet e këtij qëndrimi por edhe për ta përligjur vendimmarrjen e tij. Arsyetimi i vendimit (qoftë edhe me një argumentim të shkurtuar të pretendimeve) është detyrim kushtetues që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës dhe kodet procedurale.

8. Jemi të mendimit që shumica, në vend që t'i kërkojë Gjykatës së Lartë shpjegime lidhur me qëndrimin e saj, duke vendosur shfuqizimin e vendimit të Kolegjit të kësaj gjykate dhe detyrimin për të arsyetuar vendimin e marrë, përpiqet ta bëjë vetë një gjë të tillë. Duke vepruar në këtë mënyrë, ajo (shumica) del nga natyra e gjykimit kushtetues dhe merr atributet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në rastin konkret të Gjykatës së Lartë; mjafton t'i hedhësh një vështrim paragrafëve 12 dhe 13 të vendimit në të cilët shumica përpiqet të argumentojë drejtësinë e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë (!) (gjë që duhet ta bënte Gjykata e Lartë), për të arritur në përfundimin e mësipërm.

Këto janë arsyet përse ndajmë mendim të kundërt me shumicën. Shfuqizimi i vendimit në fjalë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i paarsyetuar, jo vetëm do të korrigjonte një vendim dhe praktikë të gabuar, tashmë të përsëritur të kolegjeve të kësaj gjykate (Gjykatës së Lartë) në vendimmarrje të kësaj natyre por, ç'ka është më e rëndësishme, do të realizonte efektivisht të drejtën kushtetuese të kërkueses për të pasur një ankim substancial në një gjykatë më të lartë, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Vladimir Kristo.

VENDIM
Nr. 41, datë 26.6.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR TRAJTIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE
MONEDHAVE SHQIPTARE TË DYSHUARA SI TË FALSIFIKUARA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c” dhe kreut V të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 11 të rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Emisionit”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 16.1.2012; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dyshuara si të falsifikuara” dhe anekset e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë dhe subjektet e rregullores të miratuar me këtë vendim, për zbatimin e kësaj rregulloreje.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet çdo akt nënligjor në kundërshtim me këtë të fundit.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR TRAJTIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE SHQIPTARE TË DYSHUARA
SI TË FALSIFIKUARA

KREU I
TË PËRGGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare (lekë) të dyshuara si të falsifikuara, me qëllim mbrojtjen e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare nga falsifikimi.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c” dhe kreut V të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;



b) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili në këtë rregullore do të quhet “ligji për bankat”;

c) nenit 11 të rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Emisionit”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 16.1.2012.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë Banka e Shqipërisë, bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Kartëmonedha dhe monedha të dyshuara” janë kartëmonedhat dhe monedhat kombëtare (lekë), të cilat gjatë procesit të kontrollit të autenticitetit, nga subjektet e kësaj rregulloreje, ose nga autoritetet e zbatimit të ligjit dyshohet të jenë të falsifikuara në lidhje me karakteristikat teknike dhe elementet e sigurisë.

b) “Elementet e sigurisë” janë cilësi teknike (letra e sigurisë, Watermark, mikro-printimet, shtypi i thellë, filli i sigurisë, ngjyra optike e ndryshueshme, përbërja e metaleve, dimensionet, pesha etj.) që synojnë parandalimin e prodhimit të paligjshëm të parave.

c) “Ekspertizë” është procedura dhe metodat e zbatuara për të përcaktuar nëse kartëmonedhat dhe monedhat objekte ekspertimi, ruajnë karakteristikat teknike të prodhimit me të gjithë elementet e sigurisë së kartëmonedhave e monedhave të emetuara në qarkullim nga Banka e Shqipërisë, dhe nëse këto karakteristika janë të vërteta ose jo.

d) “Të dhënat teknike dhe statistikore” janë të dhënat me të cilat mund të identifikohen kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara (përshkrimi teknik i llojit të falsifikimit) dhe të dhëna mbi numrin e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara sipas origjinës së tyre, veçanërisht gjeografike etj.

e) “Kartëmonedha dhe monedha të falsifikuara” janë kartëmonedhat dhe monedhat me pamjen e kartëmonedhave dhe monedhave autentike të emetuara nga Banka e Shqipërisë, të prodhuara në mënyrë të jashtëligjshme me anë të metodave falsifikuese apo modifikimeve të ndryshme, me qëllim mashtrimin.

f) “Pajisje të autentifikimit të kartëmonedhave” janë pajisjet për ekzaminimin e elementeve të sigurisë së kartëmonedhave, duke përfshirë zmadhuesit, llambat ultraviolet, kamerat me rreze infra të kuqe etj., të përdorura nga anëtarë të stafit gjatë përpunimit manual të kartëmonedhave për identifikimin e kartëmonedhave të dyshimta.

g) “Autoritete kompetente” janë autoritetet kombëtare të zbatimit të ligjit në Shqipëri, të tilla si policia e Shtetit, prokuroria etj.; si dhe autoritetet dhe strukturat e huaja të ngarkuara për parandalimin dhe zbulimin e falsifikimit, si: Banka Qendrore Europiane (ECB); Qendra e Analizës së Falsifikimit (CAC); Zyra Kundër Mashtrimit (OLAF); Qendra Tekniko-shkencore Europiane (ETSC); qendrat kombëtare homologe në vendet e tjera etj.

h) “Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës” është njësi organizative në Departamentin e Emisionit të Bankës së Shqipërisë, që ka si funksione kryesore parandalimin dhe zbulimin e falsifikimit, ekspertizës, mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave teknike dhe statistikore për paratë e falsifikuara në nivel kombëtar etj., duke bashkëpunuar për këtë qëllim me autoritetet kompetente brenda dhe jashtë vendit.

i) “Pliko” është ambalazhi i mbyllur, i tillë si: zarf, kuti ose qese, ku vendosen kartëmonedha ose monedha metalike.

KREU II KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR NJOHJEN E AUTENTICITETIT TË KARTËMONEDHËS DHE MONEDHËS SHQIPTARE

Neni 5

Veprimtaria për njohjen e autenticitetit të kartëmonedhës dhe monedhës shqiptare

1. Banka e Shqipërisë, për çdo rast të hedhjes në qarkullim të emisioneve të reja, kryen publicitetin e nevojshëm duke përdorur forma të ndryshme komunikimi e publikimi në media, njoftime zyrtare të shoqëruara me fletëpalosje ose forma të tjera botimi.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje, afishojnë në vende të përshtatshme në të gjithë rrjetin e degëve dhe agjencive, fletëpalosjet ose format e tjera të botimit të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

3. Subjektet e kësaj rregulloreje, në rastin kur personat fizikë edhe nëpërmjet fletëpalosjeve nuk arrijnë të dallojnë mirë parandë autentike, japin ndihmesën e tyre të specializuar dhe ofrojnë shpjegimet e nevojshme për dallimin e elementeve të sigurisë dhe të karakteristikave të tjera të kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim.

Neni 6

Trajnimi i punonjësve

1. Banka e Shqipërisë harton programe trajnimi dhe, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Analizës organizon dhe kryen trajnime për parandalimin dhe zbulimin e parave kombëtare të falsifikuara. Këto trajnime organizohen dhe kryhen me punonjësit e përdorimit të cash-it, autoritetet e zbatimit të ligjit, por edhe me publikun e gjerë.

2. Subjektet sigurojnë që punonjësit e trajnimit të cash-it të jenë të trajnuar për njohjen e elementeve të ndryshme të sigurisë së kartëmonedhave e monedhave kombëtare, siç janë përcaktuar dhe publikuar nga Banka e Shqipërisë, si dhe të kenë aftësinë për kontrollin e autenticitetit të tyre.

Neni 7

Kontrolli për autenticitetin e kartëmonedhave dhe monedhave

1. Subjektet sigurojnë që kartëmonedhat dhe monedhat metalike kombëtare që marrin gjatë veprimtarisë së tyre dhe që kanë për qëllim t'i hedhin përsëri në qarkullim, të kontrollohen për autenticitet sipas kërkesave dhe detyrimeve të rregullores “Për kontrollin e autenticitetit dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare”.

2. Kontrolli për autenticitetin kryhet me anë të makinerive të trajnimit të kartëmonedhave ose monedhave metalike, të testuara paraprakisht nga Banka e Shqipërisë ose në mënyrë manuale nga një anëtar i trajnuar i personelit të tyre.

3. Subjektet sigurohen, që për kontrollin manual të autenticitetit, të përdoren pajisje autentifikimi të testuara me sukses nga Banka e Shqipërisë.



KREU III

TRAJTIMI I KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE TË DYSHUARA TË FALSIFIKUARA

Neni 8

Sekuestrimi i kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara

1. Subjektet sekuestrojnë menjëherë kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara si të falsifikuara.
2. Subjektet plotësojnë procesverbalin e sekuestrimit për kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara, sipas formularit përcaktuar në aneksin nr. 1 të kësaj rregulloreje.
3. Subjektet, kur si rezultat i dyshimeve sekuestrojnë kartëmonedhat e monedhat të dyshuara dhe klienti është i pranishëm, në momentin e sekuestrimit i lëshojnë këtij të fundit një procesverbal sekuestrimi, duke i kërkuar të jetë në pritje të përfundimeve të rezultateve të ekspertizës.

Neni 9

Dorëzimi vullnetar i kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara

Subjektet pranojnë kartëmonedhat dhe monedhat kombëtare të dyshuara si të falsifikuara, kur dorëzohen vullnetarisht në sportelet e tyre nga persona fizikë apo juridikë.

Neni 10

Dorëzimi në Bankën e Shqipërisë

1. Kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara si të falsifikuara nga vetë subjektet dhe ato të dorëzuara në mënyre vullnetare i nënshtrohen procedurave dhe rregullave të kontrollit të autenticitetit sipas kësaj rregulloreje.
2. Kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara si të falsifikuara nga vetë subjektet, si dhe ato të dorëzuara në mënyre vullnetare, dorëzohen për kontroll dhe ekspertim, në Zyrën e Qendrës Kombëtare të Analizës pranë Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë. Dorëzimi kryhet jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pune nga dita e verifikimit të dyshimit apo dorëzimit vullnetar të tyre.
3. Kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara dorëzohen të mbyllura në pliko, të shoqëruar me procesverbal sekuestrimi dhe kërkesë për ekspertim sipas aneksit nr. 2 të kësaj rregulloreje. Kërkesa për ekspertim dërgohet paraprakisht edhe në trajtë elektronike.
4. Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës, pas administrimit të plikove me kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara, zbaton procedurën e mbledhjes, të regjistrimit, të ekspertizës dhe të përpunimit të të dhënave teknike e statistikore të tyre.

Neni 11

Ekspertiza e kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara

1. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Zyrës së Qendrës Kombëtare të Analizës kryen ekspertizën (analizën teknike) për kontrollin e autenticitetit të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara.
2. Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës, në përfundim të procesit të ekspertizës (analizës teknike), harton akt ekspertimin përkatës, ku pasqyrohen zhvillimet dhe vlerësimet e analizës teknike të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara objekt ekspertimi.

Neni 12

Rezultatet e ekspertimit

1. Akti i ekspertimit mbi rezultatet dhe të dhënat relevante të ekspertizës (analizës teknike) i dërgohet subjekteve dhe, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, mund t'i dërgohet dhe autoriteteve kompetente, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e marrjes në dorëzim të kartëmonedhave dhe monedhave.

2. Banka e Shqipërisë konfiskon pa kompensim të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat, të cilat në përfundim të ekspertimit (analizës teknike) rezultojnë të falsifikuara.

3. Kartëmonedhat dhe monedhat që në përfundim të ekspertimit (analizës teknike) rezultojnë autentike i kthehen menjëherë dërguesit nëpërmjet kreditimit të llogarisë përkatëse bankare ose duke kthyer fizikisht kartëmonedhat dhe monedhat në rastin e institucioneve të zbatimit të ligjit.

4. Bankat ose degët e bankave të huaja sigurojnë që vlera e kartëmonedhave ose monedhave të rezultuara autentike t'i kalohet menjëherë personit dhe/ose subjektit që i ka dorëzuar ose që i janë sekuestruar si të dyshuara.

Neni 13

Mbajtja dhe ruajtja e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara

1. Kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara do të mbahen në ruajte për një periudhë 15- (pesëmbëdhjetë) vjeçare në Bankën e Shqipërisë. Në përfundim të afatit të ruajtjes, kartëmonedhat dhe monedhat mund të asgjësohen sipas rregullave procedurale të vendosura në Bankën e Shqipërisë.

2. Mostrat e përzgjedhura nga kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara si pjesë përbërëse e albumeve apo katalogëve do të mbahen pa afat, duke qenë pjesë e inventarit të kartotekës të Zyrës së Qendrës Kombëtare të Analizës.

3. Qendra Kombëtare e Analizës do të dorëzojë kartëmonedhat dhe monedhat në ruajtje kur janë objekte shqyrtimi në çështje penale, në bazë të kërkesës me shkrim nga autoritetet dhe/ose organet kompetente.

Neni 14

Përdorimi i kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara

1. Qendra Kombëtare e Analizës përdor kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara si materiale për:

a) organizimin e seminareve dhe fushatave sensibilizuese për parandalimin e falsifikimit; dhe
b) programimin dhe testimin e makinerive dhe pajisjeve të autentifikimit të kartëmonedhave dhe/ose monedhave.

2. Banka e Shqipërisë, me qëllim programimin dhe testimin e makinerive ose pajisjeve të autentifikimit nga subjektet bankare apo sipërmarrësit e angazhuar, me kërkesën me shkrim të tyre, mund të japë për përdorim të përkohshëm mostra kartëmonedhash dhe monedhash të falsifikuara.

Neni 15

Bashkëpunimi me autoritetet e zbatimit të ligjit

1. Banka e Shqipërisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, bashkëpunon me autoritetet kompetente vendase dhe/ose të huaja për shkëmbim informacioni lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen e kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare nga falsifikimi.

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës bashkëpunon me autoritetet kombëtare të zbatimit të ligjit (polici e shtetit, prokurori etj.), gjatë kryerjes së detyrave të tyre përkatëse, në veçanti për:



a) shkëmbimin, për qëllime të analizave strategjike, të informacionit të rregullt mbi falsifikimin;

b) sigurimin e ndihmës së ndërsjellë në parandalimin dhe luftimin e veprave penale në fushën e falsifikimit të parasë, që përfshin ndër të tjera, mbështetjen shkencore dhe trajnimet me mbështetjen logjistike.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16 Zbatimi i kërkesave rregullative

1. Departamenti i Emisionit pranë Bankës së Shqipërisë, realizon verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, duke kryer veçanërisht veprimet e mëposhtme:

a) inspektime në vend, në vendndodhjet e subjekteve, për të monitoruar aftësinë e subjekteve për të kontrolluar për autenticitetin e kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara; dhe

b) verifikim të procedurave që rregullojnë trajtimin e kartëmonedhave të kontrolluara, dhe të procedurave që rregullojnë çdo kontroll manual të autenticitetit.

2. Subjektet janë të detyruara të marrin masat e nevojshme organizative dhe teknike për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e saj.

3. Nëse Banka e Shqipërisë konstaton moszbatim të dispozitave të kësaj rregulloreje, do të kërkojë marrjen e masave korrigjuese nga ana e subjekteve brenda një afati kohor të specifikuar.

Neni 17 Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 18 Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.



Nr. Prot.: _____
Vendi dhe data: _____

**KËRKESË PËR EKSPERTIM
PËR TË PËRCAKTUAR AUTENTICITETIN E MONEDHËS KOMBËTARE “LEK”**

Kartëmonedhat			
Prerjet	Numri serial	Viti i emetimit	Sasia, copë

Monedhat		
Prerjet	Viti i emetimit	Sasia, copë

Shënim. Ky formular do të plotësohet sipas renditjes duke filluar nga kartëmonedha me prerje më të madhe dhe kjo e renditur sipas vitit të emetimit më të hershëm. E njëjta renditje do të ndiqet edhe për monedhat.

Data dhe vendi i konstatimit të monedhave të dyshuara si të falsifikuara	Data:	
	Vendi:	
Rrethanat shkurt të konstatimit	Konstatimi në sportel prej arkëtarit nga klienti	<input type="checkbox"/>
	Konstatimi në procesin e përpunimit	<input type="checkbox"/>
	Konstatimi në subjekt; origjinë e panjohur	<input type="checkbox"/>
	Të tjera	<input type="checkbox"/>
Informacion mbi personin të cilit i janë sekuestruar para të dyshuara si të falsifikuara ose që kërkon vërtetimin e tyre	Emër dhe mbiemër:	
	Adresa:	
	Telefon:	
	Numër i kartës - ID ose i pasaportës	

Vendi i vulës

(nënshkrimi i personit të autorizuar)

VENDIM
Nr. 42, datë 26.6.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LICENCIMIN, RREGULLIMIN DHE
MBIKËQYRJEN E OPERATORËVE TË SKEMAVE KOMBËTARE TË PAGESAVE ME
KARTË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, nenit 53, paragrafi 4 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 2, paragrafi 1, nenit 6 paragrafët 1 dhe 2, nenit 7, nenit 8, paragrafët 1 dhe 2, neneve 9, 10, 11, 12 dhe 14 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 “Për sistemin e pagesave”; me propozimin e Guvernatorit dhe të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë”, sipas tekstit bashkëlidhur vendimit.

2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti Juridik dhe Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e vendimit.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e rregullore në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
**PËR LICENCIMIN, RREGULLIMIN DHE MBIKËQYRJEN E OPERATORËVE TË SKEMAVE
KOMBËTARE TË PAGESAVE ME KARTË**

KREU I
TË PËRGGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Rregullorja synon të garantojë sigurinë, qëndrueshmërinë, mirëfunksionimin dhe efikasitetin e skemave kombëtare të pagesave me kartë, si element përbërës i sistemeve të pagesave, me vlerë të vogël.

Neni 2
Veprimtaria

1. Veprimtaria e skemave kombëtare të pagesave me kartë përfshin të gjitha aktivitetet e mëposhtme:



- a) administrimin e përgjithshëm të skemës;
 - b) mbështetjen e emetimit të kartave, nëpërmjet prodhimit dhe personalizimit të tyre, procesimit të të dhënave, vërtetim (authentication) dhe autorizim;
 - c) mundësimin e përdorimit të kartave në ATM, terminale POS (POS/EFTPOS) terminale virtuale POS (virtual POS) etj.;
 - d) administrimin e veprimeve në терминаlet e mësipërme për kryerjen e transaksioneve, duke përfshirë edhe prodhimin e të tilla pajisjeve;
 - e) pranimin dhe shërbimet e komunikimit për kryerjen e transaksioneve; dhe
 - f) klerimin e pagesave me kartë (përfshirë edhe infrastrukturën e nevojshme për shlyerjen e transaksioneve me kartë).
2. Skema kombëtare e pagesave me kartë mund të kryejë, nëpërmjet palëve të treta, vetëm aktivitetet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “d” të pikës 1 të nenit.

Neni 3 Objekti

1. Objekti i rregullores është përcaktimi i kriterëve, afateve, dokumentacionit dhe procedurave për:
- a) licencimin e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë në Shqipëri;
 - b) dhënien e miratimeve paraprake nga ana e Bankës së Shqipërisë dhe detyrimet për njoftime nga ana e operatorit në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë;
 - c) rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së skemave kombëtare të pagesave me kartë.
2. Dispozitat e rregullores nuk zbatohen për sistemet e pagesave.

Neni 4 Baza ligjore

- Rregullorja nxirret në bazë dhe për zbatim të:
- a) nenit 1, pika 4, shkronja “b” dhe të nenit 43 shkronja “c”, nenit 53, paragrafi 4 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe
 - b) nenit 2, paragrafi 1, nenit 6 paragrafët 1 dhe 2, nenit 7, nenit 8, paragrafët 2 dhe 3, neneve 9, 10, 11, 12 dhe 14 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 “Për sistemin e pagesave”.

Neni 5 Subjekti

Subjekt i rregullores janë personat juridikë që kërkojnë të licencohen si operatorë për të ushtruar veprimtari të skemave kombëtare të pagesave me kartë në Shqipëri.

Neni 6 Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e përkufizuar në nenin 5 të ligjit për sistemin e pagesave kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.
2. Në këtë rregullore fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjellas, kurdoherë që një gjë e tillë është e nevojshme nga përmbajtja e dispozitës ose konteksti.
3. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjellas.
4. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të nenit, për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Ligji për sistemin” është ligji nr. 133/2013, datë 29.4.2013 “Për sistemin e pagesave”.
- b) “Banka” është Banka e Shqipërisë.
- c) “Skemë” është skema kombëtare e pagesave me kartë si tërësia e funksioneve, procedurave, rregullave dhe mjeteve të cilat i mundësojnë mbajtësit të një karte pagese të kryejë një pagesë, apo çdo transaksion tjetër të mundshëm; skema është katërpalëshe dhe përfshin: 1) emetuesin, 2) pranuesin, 3) kartëmbajtësin dhe 4) tregtarin.
- d) “Emetues” është banka, dega e bankës së huaj ose institucioni i parasë elektronike, të cilët emetojnë karta.
- e) “Pranues”/(acquirer) është banka dhe/ose dega e bankës së huaj, e licencuar nga Banka, që në bazë të kontratës me tregtarin pranon pagesat elektronike të iniciuara nga mbajtësi nëpërmjet kartave dhe të realizuara te tregtari, nëpërmjet POS/EFTPOS ose virtual POS, si dhe mundëson tërheqjet në cash nëpërmjet ATM-ve. Pranuesi mund të jetë njëkohësisht edhe emetues dhe e anasjella.
- f) “Kartëmbajtës” është personi, i cili në bazë të kontratës përkatëse me emetuesin mban kartën.
- g) “Tregtar” është personi fizik ose juridik, i cili në bazë të kontratës së lidhur me pranuesin, pranon pagesat me karta nëpërmjet përdorimit të një pajisjeje POS/EFTPOS/virtual POS.
- h) “Klerimi” është llogaritja dhe krijimi i pozicioneve neto vetëm për pagesat me kartë, nga ana e operatorit të skemës me qëllim shlyerjen finale në një agjent shlyerës.
- i) “Agjent shlyerës” është personi juridik që u ofron llogari shlyerjeje pjesëmarrësve në sistem, nëpërmjet të cilave shlyhen urdhër-transferatat në sistem dhe që, në raste të veçanta, mund t’u ofrojë kredi pjesëmarrësve për qëllime shlyerjeje.
- j) “Operator” është personi juridik që i vetëm, ose në bashkëpunim me persona të tjerë juridikë operon/drejton skemën; operatori ushtron veprimtarinë vetëm pas pajisjes me licencë nga ana e Bankës. Në kuptim të kësaj rregulloreje, operatori nuk mund të jetë bankë, degë e bankës së huaj ose operator i skemave ndërkombëtare.
- k) “Vërtetim” (authentication) nënkupton metodat e përdorura për të verifikuar origjinën e një mesazhi apo për të verifikuar identitetin e një pjesëmarrësi në skemë.
- l) “Pranim” është procesi i kontrollit nëse transaksioni është në përputhje me rregullat e skemës (për shembull: karta nuk ka skaduar apo është revokuar, identiteti i kartës dhe i mbajtësit të saj është i saktë dhe limitet/kufijtë financiarë të kartëmbajtësit nuk janë tejkaluar).
- m) “Administrator” është personi fizik sipas kuptimit të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; dhe
- n) “PCI DSS” (Payment Card Industry Data Security Standarts) është një set kërkesash dhe procedurash të krijuara nga shoqëritë kryesore ndërkombëtare të kartave, me qëllim që të garantohet gjithmonë siguria e të dhënave të llogarisë së klientit.

KREU II LICENCIMI

Neni 7

Autoriteti licencues

Banka është autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin e operatorëve për të ushtruar veprimtari të skemës në përputhje me dispozitat e ligjit për sistemin dhe të rregullores.

Neni 8

Kërkesa për kapitalin

1. Shuma e kapitalit fillestar minimal për t’u licencuar si operator i skemës është 20,000,000 (njëzetë milionë) lekë.



2. Banka ka të drejtë që të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin/et e krijimit të kontributeve/fondeve që do të shërbejnë si kapital fillestar minimal ose si shtesë e mëvonshme e tij.

3. Pagesat dhe/ose shpenzimet për blerjen ose për marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal.

Neni 9 **Licenca**

1. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patjetërsueshme dhe e patjetërsueshme.
2. Licenca përfshin emrin tregtar të operatorit, emërtimin “skemë kombëtare e pagesave me kartë”, numrin dhe datën e lëshimit.
3. Licenca miratohet dhe nënshkruhet nga Guvernatori i Bankës.

Neni 10 **Kërkesa në lidhje me dokumentacionin**

1. Kërkesa për licencim bëhet me shkrim nga ortakët/aksionarët, administratori i subjektit (sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur rregullores) ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tij (sipas formularit nr. 2, bashkëlidhur rregullores).

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) statuti i shoqërisë;
- b) akti i themelimit në rastin e një shoqërie të sapokrijuar;
- c) lista e ortakëve/aksionarëve dhe pjesëmarrja e tyre në kapitalin e shoqërisë;
- d) ekstrakti i regjistrimit të subjektit si person juridik në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në të cilin të jetë e përcaktuar veprimtaria për të cilën kërkohet të licencohet;

e) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për ortakët/aksionarët, administratorin dhe/ose përfaqësuesin ligjor:

- i) se personi nuk është në ndjekje penale;
- ii) se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
- iii) se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe
- iv) nga Regjistri qendror i përmbauesve gjyqësor pranë Ministrisë së Drejtësisë, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

Dokumentet e sipërcituara duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në Bankë.

f) dokumentacioni për kapitalin dhe burimin e tij:

i) deklaratë noteriale të ortakëve/aksionarëve se burimi i kapitalit fillestar të paguar të subjektit nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta;

ii) deklaratë noteriale të ortakëve/aksionarëve mbi burimin e krijimit të kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacionin vijues: evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për blerjen e aksioneve të subjektit) dhe certifikata e autoriteteve kompetente që siguron të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe rregullshmërinë e pagesës së tatimeve dhe taksave;

iii) vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka, që subjekti ka bllokuar, në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 8, paragrafi 1, 2 ose 3 sipas rastit. Kjo shumë, zhbllokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës, në përfundim të procedurës së licencimit.

- g) dokumentacioni për ortakët/aksionarët në rastin kur ata janë persona juridikë:
- i) statuti dhe ekstrakti i regjistrimit tregtar (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);
 - ii) vendimi i organit vendimmarrës të shoqërisë për pjesëmarrjen në kapitalin e operatorit; dhe
 - iii) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj.
- h) dokumentacioni për ortakët/aksionarët në rastin kur ata janë persona fizikë tregtarë ose individë:
- i) për personat fizikë tregtarë:
ekstrakti i regjistrimit në regjistrin tregtar dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale.
 - ii) për individët:
 - dokumenti i identifikimit (emër, mbiemër, kombësi, shtetësi), adresa e saktë e vendbanimit dhe një CV e nënshkruar; dhe
 - lista e bizneseve në të cilat ortaku/aksionari ka pjesëmarrje influencuese, ekstrakti i regjistrimit tregtar për secilin rast, si dhe të dhëna mbi ndonjë rast paaftësie paguese dhe/ose falimentimi.
 - i) dokumentacioni për administratorin:
 - i) vendimi i organeve vendimmarrëse të shoqërisë për emërimin e tij;
 - ii) dokumenti i identifikimit;
 - iii) CV-ja e nënshkruar;
 - iv) diploma universitare dhe dokumente që vërtetojnë kualifikimet e tjera të administratorit;
 - v) të paktën një referencë nga punëdhënësi të mëparshëm; dhe
 - vi) deklaratë personale për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale.
 - j) Planbiznesi, për një periudhë jo më pak se 3 (tri) vjet, me përmbajtje si më poshtë:
 - i) një plan për zhvillimin dhe konceptin ekonomik të aktivitetit të subjektit, i cili duhet të bazohet në vlerësime realiste dhe të justifikojë aftësitë e subjektit për të përdorur burimet teknike dhe financiare, si dhe sistemet dhe procedurat në mënyrë të tillë që të garantojë një funksionim normal dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë, për të cilën subjekti kërkon të licencohet; parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për 3 (tri) vitet e para të veprimtarisë bëhet sipas formularit nr. 3, bashkëlidhur rregullores.
 - ii) një analizë të rreziqeve ndaj të cilave subjekti dhe/ose pjesëmarrësit janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen në të ardhmen, parimet dhe masat për administrimin e rreziqeve;
 - iii) një përshkrim të pajisjeve teknike dhe burimeve të nevojshme për të kryer veprimtarinë, duke përfshirë këtu sisteme të përshtatshme kompjuterike, informatike, kontabël dhe të regjistrimit;
 - iv) një informacion lidhur me mjediset/vendndodhjen/ambientet ku subjekti parashikon të kryejë aktivitete, pajisjet përkatëse, si dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre; dhe
 - v) një përshkrim të organigramës, duke përfshirë skemën organizative.
 - k) Rregullore/manuale dhe dokumente në lidhje me administrimin e skemës, duke përfshirë:
 - i) strukturën organizative dhe përgjegjësitë kryesore për çdo funksion ose njësi organizative;
 - ii) sistemet dhe procedurat për identifikimin, administrimin, kontrollin dhe raportimin e rreziqeve ku operatori i skemës ose pjesëmarrësi janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen në të ardhmen;
 - iii) sistemet dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm, procedurat administrative dhe kontabël, të cilat përfshijnë metodat dhe mjetet e monitorimit dhe kontrollit efektiv të rrezikut, duke përfshirë këtu edhe rrezikun e përdorimit të skemës për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;



iv) masat të cilat sigurojnë vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve të skemës;

v) procedurat dhe masat për një drejtim sa më të mirë të konflikteve potenciale të interesit që mund të lindin gjatë kryerjes së veprimtarisë;

vi) organizimin dhe administrimin e sistemit të informacionit, duke përfshirë mënyrën e ruajtjes dhe mbrojtjes së informacionit dhe të dhënave personale për pjesëmarrësit apo për subjektet e tjera të interesuara për t'u përfshirë në skemë;

vii) rregullat e operimit të skemës;

viii) projekt marrëveshjen tip me pjesëmarrësit, e cila përmban rregullat e përgjithshme dhe procedurat standarde për ekzekutimin e transfertave. Kërkuesi dorëzon të paktën një marrëveshje të nënshkruar me një pjesëmarrës, të lidhur me kushtin e hyrjes në fuqi pas marrjes së licencës;

ix) kriteret e përgjithshme për pranimin, përjashtimin dhe mbikëqyrjen e pjesëmarrësve;

x) certifikime nga vlerësues të kualifikuar ndërkombëtarë mbi përmbushjen e kërkesave sipas PCI DSS. Këto certifikata nëse nuk paraqiten në momentin e kërkesës për licencim, duhet të paraqiten me fillimin e aktivitetit të procesimit; dhe

xi) marrëveshje me shkrim për marrëdhënie me të tretët/outsourcing (e lidhur me kushtin e hyrjes në fuqi pas dhënies së licencës) për nënkontraktimin e aktiviteteve të lejueshme sipas pikës 2 të nenit 2, nëse aktiviteti i skemës do të mbështetet në një marrëdhënie të tillë.

3. Dokumentacioni sipas paragrafit 2 paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni paraqitet i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

5. Subjekti, përveç dokumentacionit të përcaktuar në këtë nen, dorëzon pranë Bankës edhe formularët nr. 4 dhe nr. 5.

6. Formularët 1- 5, bashkëlidhur, janë pjesë përbërëse e rregullores.

Neni 11

Kërkesa për administratorët

1. Administratorët e operatorit plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:

a) të kenë diplomë universitare, si rregull në ekonomi ose teknologji informacioni;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se 3 (tre) vjet në fushën

ekonomike/financiare/bankare ose në ndonjë fushë tjetër të konsideruar të përshtatshme nga Banka;

c) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional;

d) të mos kenë shkaktuar ose të mos kenë qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;

e) të mos jenë në ndjekje penale ose të mos jenë shpallur fajtorë nga gjykata për një vepër penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

f) të mos kenë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ose falimentimit, si dhe të jenë të çliruar nga pagesa e detyrimeve pasurore të kaluara;

g) të mos jenë ndëshkuar nga Banka gjatë 5 (pesë) vjetëve të fundit për shkelje të rënda të legjislacionit bankar.

Neni 12

Kriteret për dhënien ose refuzimin e licencës

1. Banka merr vendim për dhënien e licencës vetëm kur krijon bindjen se operatori plotëson kërkesat e ligjit për sistemin dhe të rregullores.

2. Banka refuzon dhënien e licencës kur nuk plotësohen kërkesat e ligjit për sistemin dhe të rregullores, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) në gjykimin e saj, plan biznesi i propozuar nuk paraqet besueshmëri për realizimin e veprimtarisë së skemës;

b) të paktën njëri nga administratorët ose ortakët/aksionarët ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ose falimentimit;

c) nuk paraqitet informacion lidhur me identitetin e ortakëve/aksionarëve;

d) vërtetohet se të paktën njëri nga ortakët/aksionarët:

i) është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

ii) është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizimit; dhe

iii) kur ndaj tij është marrë vendimi nga gjykata për moslejimin e ushtrimit të profesionit.

e) nuk zotëron shumën e kapitalit fillestar minimal të kërkuar nga Banka.

3. Banka, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit sipas paragrafit 1 ose 2 të nenit, i njofton subjektin vendimin për dhënien e licencës ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, të shoqëruar me arsyet përkatëse.

Neni 13

Procedurat dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për licencim

1. Banka shqyrton dokumentacionin e paraqitur në përputhje me kërkesat e ligjit për sistemin dhe të rregullores.

2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në rregullore, Banka brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune i dërgon njoftim subjektit për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e ligjit për sistemin dhe të rregullores, së bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacion shtesë.

3. Banka jep ose refuzon dhënien e licencës brenda 3 (tre) muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë.

4. Data e pranimit të kërkesës për licencë konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas nenit 10 të rregullores. Kjo datë i njoftohet me shkrim subjektit nga Banka.

5. Banka ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencë, Banka njofton me shkrim subjektin.

6. Banka pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë sipas kërkesave të ligjit për sistemin dhe të rregullores, si dhe pas plotësimit të informacionit shtesë sipas paragrafit 3 të nenit:

a) shqyrton dhe analizon dokumentacionin e paraqitur;

b) vlerëson aftësinë profesionale të administratorëve; dhe

c) organizon nëse e çmon të nevojshme takime me operatorin për të diskutuar planbiznesin e paraqitur dhe probleme të tjera të lidhura me veprimtarinë e propozuar.

7. Banka mund të inspektojë mjediset/zyrat ku do të zhvillohet veprimtaria e subjektit, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e tyre.

8. Shqyrtimi i dokumentacionit të licencimit dhe inspektimi i mjedisëve/zyrave të punës kryhet nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave, në bashkëpunim rast pas rasti me Departamentin Juridik, Departamentin e Mbikëqyrjes, Departamentin e Teknologjisë së Informacionit dhe Departamentin e Sigurimit dhe Mbrojtjes në Bankë.



Neni 14

Publikimi i vendimit për dhënien e licencës

Banka publikon vendimin për dhënien e licencës për të operuar skemën në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës, si dhe në listën e sistemeve të Bankës në faqen zyrtare të saj në internet.

Neni 15

Komisioni

1. Subjekti që kërkon dhënien e licencës për të operuar skemën paguan një komision për përpunimin e kërkesës për licencë në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) lekë në Bankë, në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.
2. Komisioni nuk rimbursohet në rast të refuzimit të dhënies së licencës nga Banka.

Neni 16

Revokimi ose pezullimi i licencës

1. Banka mund të revokojë ose pezullojë licencën e operatorit të skemës bazuar në nenin 7 të ligjit për sistemin, dhe në rast se kërkohet nga vetë operatorit.
2. Vendimi për pezullimin ose revokimin e licencës, i arsyetuar, i komunikohet menjëherë me shkrim operatorit dhe hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka.
3. Vendimi i pezullimit ose revokimit të licencës publikohet nga Banka në Buletinin Zyrtar të saj.
4. Operatori ndalohet të kryejë veprimtaritë e përcaktuara në licencë pas hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës për revokimin e saj, ose për aq kohë sa zgjat shkak apo afati i pezullimit.

KREU III

MIRATIMET PARAPRAKE DHE DETYRIMET PËR NJOFTIM

Neni 17

Miratimet paraprake

1. Operatori i skemës, pa miratimin paraprak të Bankës, nuk mund:
 - a) të zvogëlojë kapitalin;
 - b) të emërojë një ose disa administratorë; dhe
 - c) të nënshkruajë marrëveshje me të tretët (outsourcing) për kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “d” të paragrafit 1 të nenit 2 të rregullores.
2. Banka jep ose refuzon miratimin paraprak, sipas paragrafit 1, brenda 2 (dy) muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 18 të rregullores.
3. Miratimet paraprake ose refuzimet jepen nga Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës.

Neni 18

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimet paraprake

1. Operatori i skemës për të marrë miratimet paraprake të përcaktuara në nenin 17 të rregullores, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) për zvogëlimin e kapitalit:
 - i) vendimin e asamblesë për zvogëlimin e kapitalit; dhe
 - ii) relacionin shoqërues me arsyet e këtij ndryshimi.
 - b) për të emëruar administratorin/ët:
 - i) vendimin e strukturës vendimmarrëse për emërimin e administratorit/ëve; dhe
 - ii) dokumentacionin sipas shkronjës “j”, paragrafit 2 të nenit 10 të rregullores.
 - c) për marrëveshjet me të tretët (*outsourcing*):
 - i) kontratat përkatëse (të lidhura me kushtin e hyrjes në fuqi pas dhënies së miratimit paraprak nga ana e Bankës); dhe
 - ii) vendimin e organit drejtues për lidhjen e marrëveshjeve me të tretë me qëllim *outsourcing* e aktiviteteve të lejuara.
2. Banka sipas rastit mund të kërkojë edhe dokumente shtesë, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 19 Detyrimet për njoftim

1. Operatori, njofton menjëherë Bankën në rastet e:
- a) ngjarjeve të jashtëzakonshme në rast të paaftësisë paguese ose ndërprerjen e veprimtarisë së pjesëmarrësve në skemë;
 - b) ngjarjeve të jashtëzakonshme në rast të problemeve në funksionimin e skemës, duke përfshirë masat korrigjuese të ndërmarra;
 - c) ngjarjeve të veçanta që mbulojnë të dhënat specifike të kërkuara nga Banka me qëllim të kryerjes së mbikëqyrjes mbi operacionet e skemës;
 - d) vlerësimit se ka shkaqe të justifikuar për ndërprerjen ose pezullimin e ndonjë prej aktiviteteve të skemës;
 - e) vlerësimit se ka shkaqe për revokimin e licencës; dhe
 - f) çdo ndryshimi në listën e pjesëmarrësve dhe nënpjesëmarrësve të skemës.
2. Operatori njofton Bankën brenda 30 (tridhjetë) ditëve për:
- a) ndryshimin e emrit;
 - b) ndryshimin e statutit;
 - c) zmadhimin e kapitalit;
 - d) ndryshimet në strukturën e kapitalit;
 - e) ndryshime në strukturën organizative;
 - f) ndryshim të selisë dhe adresës;
 - g) largimin e administratorëve;
 - h) ndryshimin e rregulloreve të brendshme/metodat/çdo dokumentacion tjetër që shërben për të siguruar mirëfunksionimin e skemës;
 - i) studimin e fizibilitetit për çdo produkt të ri që mendohet të ofrohet nga skema; dhe
 - j) çdo ndryshim tjetër që është i detyrueshëm për regjistrim në regjistrin tregtar.
3. Në rastin e ndryshimit të emrit, pas kërkesës së operatorit, Banka e pajis atë me një format të ri licence në të cilin pasqyrohet emri i ri.



KREU IV PARIMET QË RREGULLOJNË VEPRIMTARINË E SKEMËS

Neni 20

Përputhshmëria me kërkesat

1. Operatori kryen veprimtarinë e tij në përputhje me parimet e administrimit të kujdesshëm, të përcaktuara në nenet 21 deri në 24 të rregullores, si dhe bazuar në standardet dhe praktikat më të mira, duke:

a) marrë masat e duhura për kufizimin e rreziqeve; dhe
b) siguruar nivele të larta të transparencës dhe përpikmërisë, funksionimit të vazhdueshëm dhe efikas të skemës.

2. Në rastin e ndryshimeve të rëndësishme të funksionimit të skemës, të shërbimeve të ofruara dhe futjes së shërbimeve të reja, operatori organizon forma të përshtatshme konsultimi me përdoruesit, në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i nismës dhe përshtatshmëria e funksionaliteteve të ofruara.

3. Në mënyrë që të sigurohet ofrimi i shërbimeve të sigurta dhe efikase nga skema, operatori përmbush kërkesat specifike teknike, organizative dhe funksionale të përcaktuara në rregullore gjatë gjithë veprimtarisë së tij.

Neni 21

Transparenca

1. Operatori harton dhe miraton procedura të qarta për pranimin e pjesëmarrësve në skemë.

2. Operatori rishikon në mënyrë periodike të gjitha rregullat/procedurat/dokumentet që administrojnë skemën.

3. Operatori siguron që të gjitha palët që kanë marrëdhënie me të, përfshirë subjektet potenciale për t'u përfshirë në skemë, të kenë akses në informacionet e rëndësishme që shërbejnë në vlerësimin e ekspozimit ndaj rrezikut financiar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Operatori siguron që pjesëmarrësit dhe subjektet e tjera të interesuara, të aksesojnë lehtësisht informacionin e duhur/e nevojshëm për ta. Operatori vë në dispozicion informacionin me karakter sensitiv (si për shembull: informacioni në lidhje me elementet e sigurisë të përdorur për prodhimin e terminaleve/ATM, POS me qëllim shmangien e situatave të mashtrimit) vetëm pas kërkesës përkatëse.

4. Operatori publikon qartë dhe dukshëm komisionet dhe tarifatat e shërbimeve.

Neni 22

Siguria, efikasiteti operacional dhe vijueshmëria e biznesit

1. Operatori, me qëllim administrimin e sigurisë së skemës:

a) analizon të paktën 2 (dy) herë në vit, rreziqet operationale dhe të sigurisë me qëllim përcaktimin e niveleve të pranueshme të tyre, si dhe harton politika të përshtatshme, të cilat synojnë të parandalojnë, të identifikojnë dhe korrigjojnë shkeljet e sigurisë;

b) përzgjedh dhe trajnon drejtuesit dhe stafin me qëllim krijimin e kapaciteteve profesionale të afta për të siguruar zbatueshmërinë e duhur të politikave të miratuara;

c) përcakton në mënyrë të qartë dhe zbaton në mënyrë efikase politikat operationale dhe ato të ngjarjeve të paparashikuara; dhe

d) harton politika sigurie, të tilla që të garantojnë privatësinë, integritetin dhe origjinalitetin e të dhënave, duke përfshirë dhe mbrojtjen e të dhënave sekrete gjatë operimit, ruajtjes dhe

shkëmbimit (si për shembull: PIN). Operatori harton plane të emergjencës në rast se të dhënat komprometohen ose përhapen.

2. Operatori, në kuadër të prodhimit dhe të shpërndarjes së kartave, siguron që:

a) dizenjimi dhe prodhimi i kartave të pagesave, pajisjeve për pranimin e kartave, si dhe i pajisjeve të tjera teknike duhet të garantojë siguri të mjaftueshme në përputhje me politikat e sigurisë së skemës; dhe

b) të hartohen procedura efikase dhe të sigurta për fillimin, personalizimin dhe shpërndarjen:

i) e kartave të kartëmbajtësi;

ii) e terminaleve të pranuesit të kartave; dhe

iii) e gjenerimit dhe shpërndarjes së elementeve sekrete (si për shembull: PIN).

3. Operatori harton standarde sigurie të përshtatshme dhe në përputhje me politikat e sigurisë në lidhje me fillimin e transaksionit, të cilat sigurojnë që:

a) skema të ketë kapacitetet e nevojshme për minimizimin e rreziqeve që vijnë nga përdorimi i kartës pa autorizim *online*, apo me autorizime më pak të sigurta;

b) aktivitetet e mbajtësit të kartës dhe të pranuesit të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim reagimin e menjëhershëm në rast të mashtrimit dhe merr masat e nevojshme për minimizimin e efekteve që mund të sjellin të tilla veprime (mashtrimet);

c) skema të mundësojë procesimin e pagesave edhe në momentet e përqendrimit maksimal të veprimtarisë së skemës; dhe

d) të ketë të dhëna të mjaftueshme me qëllim zgjidhjen/sqarimin transparent dhe të thjeshtë të çdo mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve.

4. Operatori siguron që marrëveshjet e klerimit dhe të shlyerjes të garantojnë nivele të përshtatshme të sigurisë, operim të qëndrueshëm, të sigurt dhe të disponueshëm, duke marrë në konsideratë afatet e shlyerjes të përcaktuara.

5. Operatori harton dhe miraton plane të vazhdimësisë (kontigjencës), të cilat përcaktojnë qartë elementet që janë thelbësorë për mirëfunksionimin e skemës, përfshirë veprimet konkrete në rast të forcave madhore. Ato testohen dhe përditësohen në mënyrë periodike.

6. Operatori në lidhje me marrëveshjet me të tretët (*outsourcing*) siguron që:

a) rreziqet që lindin nga nënkontraktimi i disa prej aktiviteteve të skemës të adresohen shprehimisht në dispozitat përkatëse kontraktore. Kontrata duhet të parashikojë të gjitha çështjet e rëndësishme, për të cilat është përgjegjës operator;

b) palët në këtë marrëdhënie të veprojnë në përputhje me standardet, për zbatimin e të cilave ai vetë është përgjegjës. Çdo veprim në zbatim të kontratave duhet të jetë i dokumentuar.

Neni 23

Administrim efikas, i besueshëm dhe transparent

1. Operatori harton dhe zbaton procedura efikase dhe transparente në rastet kur:

a) merr vendime në lidhje me objektivat dhe politikat e veprimtarisë së tij, duke përfshirë këtu edhe politikat mbi emetuesit dhe pranuesit;

b) rishikon performancën, përdorimin dhe përshtatshmërinë e skemës; dhe

c) identifikon, minimizon dhe raporton rreziqe të rëndësishme për veprimtarinë e tij.

2. Operatori merr masa që në strukturën e tij të ketë një funksion ose njësi të kontrollit të brendshëm.

3. Operatori merr masa që të kontrollohet edhe nga një auditor i jashtëm, i cili të garantojë ekspertizën e nevojshme në fushën e teknologjisë dhe informacionit të aktiviteteve të skemës.



Neni 24

Administrimi i rreziqeve financiare gjatë procesit të klerimit dhe shlyerjes

1. Operatori identifikon rreziqet financiare në procesin e klerimit dhe të shlyerjes dhe përcakton masa të përshtatshme për adresimin e tyre.
2. Operatori duhet të sigurohet që të gjithë agjentët shlyerës të përzgjedhur për finalizimin e transaksioneve (shlyerjes) të jenë mjaftueshëm të besueshëm dhe të sigurtë në aktivitetin e tyre.
3. Operatori merr masa me qëllim realizimin/përfundimin e shlyerjes edhe në rastet kur emetuesi shfaq paaftësi paguese. Operatori duhet të sigurohet që çdo detyrim i ndërmarrë nga një pjesëmarrës nuk tejkalon burimet e tij financiare, që potencialisht mund të ndikojnë në aftësinë paguese të tij. Operatori duhet të sigurojë që pjesëmarrësit të jenë në dijeni për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet, bazuar në parimet e transparencës.

KREU V MBIKËQYRJA

Neni 25

Mënyrat e mbikëqyrjes

1. Banka realizon mbikëqyrjen e skemës nëpërmjet:
 - a) inspektimit në vend; dhe
 - b) inspektimit në distancë.
2. Banka, në rast se e gjykon të arsyeshme, mund të vendosë standarde dhe kërkesa të tjera shtesë mbi operatorin, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit e skemës.
3. Për qëllime të mbikëqyrjes së veprimtarisë së skemës, Banka mbikëqyr edhe aktivitetet për të cilat skema ka lidhur marrëveshje me të tretët/outsourcing sipas nenit 17, paragrafi 1, shkronja "c".

Neni 26

Inspektimi në vend

1. Me qëllim që të sigurohet dhe të kontrollohet zbatimi i Ligjit për sistemin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, punonjës të Bankës, si dhe persona të tjerë të kualifikuar, të autorizuar prej saj, mund të inspektojnë ambientet e punës të skemës, operatorin, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit, për të kontrolluar llogaritë, regjistrat, dokumentet dhe shkresa të tjera, për të marrë informacion dhe të dhëna prej tyre, si dhe të ndërmarrin veprime të tjera që Banka mund të vlerësojë si të nevojshme.
2. Operatori, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit, vënë në dispozicion të Bankës llogaritë, regjistrat, dokumente dhe shkresa të tjera të kërkuara nga Ligji për sistemin dhe nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Operatori, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit vënë në dispozicion të Bankës çdo lloj informacioni dhe të dhënë shtesë, të cilat Banka i vlerëson si të nevojshme.

Neni 27

Inspektimi në distancë

1. Banka kryen inspektimin në distancë nëpërmjet njoftimeve të detyrueshme që operatori i jep në bazë të nenit 19 të rregullores, si dhe marrjes së raportimeve periodike nga operatori.
2. Operatori 1 (një) herë në vit dorëzon pranë Bankës raportin e auditorit të jashtëm bashkë me pasqyrat financiare, dhe një shtojcë të posaçme, sipas nenit 28 të rregullores.

3. Raporti i mësipërm dërgohet në Bankë brenda 7 (shtatë) ditëve nga dorëzimi tek operatori, por jo më vonë se 5 (pesë) muaj nga mbyllja e vitit kalendarik për të cilin po raporton.
4. Operatori çdo 3 (tre) muaj dorëzon pranë Bankës:
 - a) volumin e transaksioneve të realizuara;
 - b) numrin e terminaleve të ofruara; dhe
 - c) raportet/rezultatet e testeve në strukturat teknologjike.
5. Operatori i dorëzon Bankës vlerësimet periodike të vlerësuesve të kualifikuar ndërkombëtarë sipas standardeve PCI DSS.
6. Banka mund t'i kërkojë operatorit raportime *ad hoc* për çështje të veçanta dhe operatori vë në dispozicion informacionin sa herë që i kërkohet.

Neni 28

Shtojca e raportit të auditorit të jashtëm

Shtojca e posaçme përmban:

1. Vlerësimin e përputhshmërisë me rregullat e administrimit të rrezikut:
 - a) auditori i jashtëm kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e rregullave të administrimit të rrezikut të skemës, në përputhje me përcaktimet e rregullores;
 - b) auditori i jashtëm vlerëson mjaftueshmërinë e sistemeve të administrimit të rreziqeve të skemës duke u bazuar në vlerësimin e:
 - i) përputhshmërisë me kërkesat për strukturat organizative në lidhje me administrimin e çdo rreziku të veçantë;
 - ii) politikave dhe procedurave për administrimin e çdo rreziku të veçantë, si dhe të zbatimit të tyre;
 - iii) mjaftueshmërisë së identifikimit, matjes dhe monitorimit të çdo rreziku të veçantë; dhe
 - iv) mjaftueshmërisë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në lidhje me administrimin e çdo rreziku të veçantë.
2. Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm:

Auditori i jashtëm kryen një vlerësim të veçantë të sistemit të kontrollit të brendshëm të skemës, duke vlerësuar nëse:

 - a) operatori ka ngritur një sistem kontrolli të brendshëm të sigurt dhe efikas, në përputhje me përcaktimet e rregullores;
 - b) operatori ka krijuar njësinë e kontrollit të brendshëm, si njësi të pavarur nga pikëpamja funksionale dhe organizative nga njësitë e tjera organizative të skemës, të cilat kontrollojnë dhe nëse ajo funksionon në përputhje me përcaktimet e rregullores;
 - c) operatori ka krijuar sistem kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për të shmangur konfliktin e interesave; dhe
 - d) operatori ka siguruar një numër të mjaftueshëm personeli, me kualifikime të duhura profesionale dhe përvojë, për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në mënyrë proporcionale me madhësinë, llojin, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarive.
3. Vlerësimin e sistemit të informacionit:
 - a) Auditori i jashtëm kryen një vlerësim të veçantë të gjendjes dhe të mjaftueshmërisë së sistemit për administrimin e informacionit të skemës. Për këtë qëllim, ai:
 - i) përcakton paraprakisht qëllimin dhe thellësinë e vlerësimit bazuar në vlerësimin e rrezikut (*risk-based*);
 - ii) zbaton metodat dhe procedurat e këtij vlerësimi bazuar në vlerësimin e rrezikut (*risk-based*); dhe
 - iii) verifikon përputhshmërinë e sistemit të administrimit të informacionit me kërkesat/përcaktimet e rregullores.



b) Auditori i jashtëm, bazuar në vlerësimin e sistemit të informacionit sipas shkronjës “a”, përcakton rreziqet kryesore ndaj të cilave skema është e ekspozuar.

Neni 29

Kompetenca vendimmarrëse të Bankës

Banka mund të nxjerrë urdhra, udhëzime dhe vendime, nëpërmjet të cilave t'i kërkojë skemës, operatorit, pjesëmarrësve dhe nënpjesëmarrësve për të vepruar ose për të mos vepruar, në çfarëdo mënyre që Banka e vlerëson të nevojshme ose të këshillueshme.

Neni 30

Masa ndëshkimore

1. Në rast të shkeljes së dispozitave të ligjit për sistemin dhe të rregullores, përveç sanksioneve të përcaktuara në nenin 12 të ligjit për sistemin, Banka mund të vendosë të ndërmarrë masat e mëposhtme:

a) Masa mbikëqyrëse. Banka merr ndaj operatorit një ose disa nga masat e mëposhtme:

i) i kërkon rritje të kapitalit dhe të burimeve financiare, me qëllim që të sigurojë funksionimin e sigurt, të rregullt dhe të vazhdueshëm të veprimtarisë së skemës në kuadër të adresimit të ekspozimeve të mundshme;

ii) urdhëron ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje, si dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave ligjore ose nënligjore;

iii) vendos sanksione;

iv) revokon licencën.

b) Masa parandaluese. Banka merr ndaj operatorit një ose disa nga masat e mëposhtme:

i) Banka paralajmëron operatorin për dorëzimin e certifikatave të vlerësuesve të kualifikuar ndërkombëtarë mbi përmbushjen e kërkesave sipas PCI DSS, në rast se ai nuk i ka dorëzuar me fillimin e aktivitetit të procesimit;

ii) Banka paralajmëron operatorin për mosrespektimin e standardeve për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme dhe për këtë qëllim kërkon prej saj paraqitjen e një plani ose marrëveshjeje për ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave të Ligjit për sistemin dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe respektimin e standardeve për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme.

Në zbatim të paragrafit 1 të pikës “ii” të këtij neni, operatori paraqet në Bankë planin apo marrëveshjen e mësipërme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, sipas paragrafit 1 ose sipas afatit të caktuar nga Banka.

Banka, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së planit ose marrëveshjes së propozuar nga operatori, njofton me shkrim këtë të fundit për miratimin ose jo të tyre, si dhe kërkon informacion shtesë, nëse gjykohet e arsyeshme. Banka mund të zgjasë afatin, brenda të cilit jepet njoftimi për miratimin e planit ose marrëveshjes.

2. Banka ndërmerr veprime të mëtejshme në rast të mosrespektimit të detyrimeve që rrjedhin nga ligji për sistemin dhe aktet nënligjore.

3. Sanksionet administrative dhe masat ndëshkimore merren nga Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës.

4. Revokimi dhe pezullimi i licencës miratohet nga Guvernatori i Bankës.

Neni 31
Ankimi

1. Operatori i cenuar nga një akt administrativ i Bankës ka të drejtë të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e këtij akti nga Guvernatori i Bankës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose nga data e publikimit të tij.

2. Banka, para nxjerrjes së aktit administrativ, i jep operatorit, ndaj të cilit propozohet marrja e masës, të drejtën për t'u shprehur me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve, në lidhje me marrjen e masës së propozuar.

3. Realizimi i ankimit administrativ te Guvernatori është kusht i domosdoshëm për ezaurimin e rekursit administrativ dhe për t'i dhënë mundësi operatorit të cenuar për t'iu drejtuar gjykatës.

4. Ankimi administrativ, sipas paragrafit 1, nuk e pezullon zbatimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Banka, në rastet kur kjo e fundit çmon se stabiliteti i sistemit financiar në tërësi, mund të cenohet apo të rrezikohet nga efekti pezullues i ankimit.

5. Ankimi administrativ paraqitet në formë shkresore dhe duhet të shprehë shkaqet për të cilat ankimohet akti administrativ, si dhe duhet të ketë të bashkëlidhur një kopje të aktit.

6. Në të gjitha ato raste kur Banka çmon se zbatimi i menjëhershëm i aktit administrativ i shërben interesave të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar në tërësi, ajo mund ta kushtëzojë fillimin e procedurës së ankimit administrativ me ofrimin nga ana e shtetasve ose subjekteve juridike të cenuara, të garancive juridike të përshtatshme për ekzekutimin paraprak dhe të menjëhershëm të aktit administrativ.



**KËRKESË
PËR BANKËN E SHQIPËRISË
PËR T’U LICENCUAR
SI SKEMË KOMBËTARE E PAGESAVE ME KARTË**

Emri i subjektit: _____

Vendndodhje e propozuar: Adresa _____, Shqipëri
(qyteti) (rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari si “Skemë kombëtare e pagesave me kartë”.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë, angazhohemi për zbatimin e ligjit “Për sistemin e pagesave” dhe të akteve nënligjore përkatëse.

Kërkuesit

P.S: Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të rregullores dërgohen në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Sistemeve të Pagesave
Banka e Shqipërisë
Rruga e Dibrës, kompleksi “Halili”, Kulla B
Tiranë, Shqipëri

VENDIMI

I -----
(ORGANIT VENDIMMARRËS)
PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE

----- (organi vendimmarrës) vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, ----- (organi vendimmarrës) emëron dhe përcakton si përfaqësues:

(emri) (atësia) (mbiemri)

Adresa: _____
(rruga, numri) (qyteti) (shteti)

(numri i telefonit)

(numri i faksit/teleksit)

Përfaqësuesi i mësipërm është i autorizuar të përfaqësojë subjektin dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë, do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e ----- (organit vendimmarrës).

Përfaqësuesi është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari, nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë.

Datë _____,

(emri, mbiemri)

(nënshkrimi)

Shënim. Ky formular duhet të vërtetohet nga noteri.



PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR 3 VITET E PARA TË AKTIVITETIT

TË ARDHURAT

TOTALI I TË ARDHURAVE

_____ lekë

SHPENZIMET

TOTALI I SHPENZIMEVE

_____ Lekë

TË ARDHURAT NETO PARA TAKSAVE

_____ Lekë

DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës unë deklaroj se informacioni i paraqitur këtu, me sa di dhe besoj, është i vërtetë dhe i saktë. Ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Deklaroj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport, mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë pjesëmarrjen time në kërkesë dhe në atë shkallë që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve, pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim, kjo mund të shërbejë si shkak për refuzimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Data)

(nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

(nënshkrimi i përgatitësit)

Nënshkruar në datë: _____

(nënshkrimi i noterit publik)

Shënim. Do të plotësohet nga çdo ortak/aksionar.



AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL
(Të plotësohet secili prej të dy formularëve të autorizimit në origjinal!)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firmë, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Sistemeve të Pagesave apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time

data _____,

**KY DOKUMENT ËSHTË I
VLEFSHËM PËR 6 MUAJ**

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firmë, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Sistemeve të Pagesave apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time

data _____,

**KY DOKUMENT ËSHTË I
VLEFSHËM PËR 6 MUAJ**

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

Shënim. Do të plotësohet nga çdo ortak/aksionar.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 29.7.2013
Doli nga shtypi më 29.7.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 46 lekë